

AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ALFA & OMEGA”SH.P.K.



Sot me date 09.10.2003:

1. Mario VALENTE, i biri i Timoteos, shtetas Italian, i datelindjes 13.08.1929, me banim ne Torino, ne adresen: Corso Peschiera, 355/9, Cap.10141, Itali, mbajtesi pasaportes nr.769449A.
2. Carlo BISCEGLIA, i biri i Micheles, shtetas Italian, i datelindjes 23.06.1938, banues ne Rome ne adresen: Via Tazio Nuvolari, nr.243/E 00142 Itali.
3. Alban NEXHIPI, i biri i Hysenit, shtetas shqiptar, i datelindjes 16.07.1971, banues ne adresen: Gjon Buzuku, nr.70 Tirane, mbajtes i leternjoftimit NF488431.
4. Enver BERISHA, i biri i Kamberit, shtetas shqiptar, i datelindjes 23.12.1968, banues ne adresen: Rr.Gjik Kuqali, nr.37, Tirane, mbajtes i pasaportes nr.1443315.
5. Lefter ROKO, i biri i Xhevairit, shtetas shqiptar, i datelindjes 01.05.1978, banues ne adresen: Rruga e Elbasanit, Pall. prane konviktit te Gjuheve te Huaja. Nr.1/5.

te gjithe persona madhore me zotesi te plete per vepruar, te cilet nepermjet ketij Akti-Themelimi, themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar, “ALFA & OMEGA”SH.P.K., dhe per kete qellim duke u mbeshtetur ne Ligjin per Shoqerite Tregetare percaktojne permbajtjen e Akitit te Themelimit te Shoqerise me permbajtje si vijon:

NENI 1  
EMERTIMI

- 1.1 Shoqeria tregtare private me pergjegjesi te kufizuar emertohet “ALFA & OMEGA”SH.P.K., shkurt “A&O”, e cila ketu e më poshtë do te quhet “Shoqeria”,

NENI 2  
FORMA

- 2.1 Kjo Shoqeri eshte nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.


NENI 3  
BAZA LIGJORE

- 3.1 Shoqeria krijohet në baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe, si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne perputhje me kete legjislacion dhe me normat e ketij Statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

NENI 4  
SELJA

*(Handwritten signatures of Salvatore Bisceglia, Carlo Berisha, Lefter Roko, and others)*

- 4.1 Selia e Shoqërisë eshte ne Durres, ne adresen: Lagje Lagje "Vaso Pasha", Pall. 13/1 Tirane.
- 4.2 Shoqëria do ta konsiderojë qendrën e vet si Shoqëria Nënë, e cila rast pas rasti do të hapet me anë filialesh ose shoqërish të përbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shikojë interes në përpunjen e qëllimit të saj, në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose edhe jashtë saj.

  
NENI 5  
KOHEZGJATJA

- 5.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte per një periudhe pa afat.

NENI 6  
TERRITORI

- 6.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 6.2 Shoqëria mund të krijojë dege (filiale) ose perfaqesi, si ne rrethe te ndryshme te Republikës se Shqiperise ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 7  
OBJEKTI


Objekt i Aktivitetit të Shoqërise eshte:

- 7.1 Kryerja e veprimitarise radiotelevizive ne menyre eskluzive dhe nepermjet transmetimit ne Radio Lokale (vendore).

NENI 8  
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET

- 8.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000Leke (njeqindmije).
- 8.2 Kapitali themeltar përbëhet nga kontributi i Ortakeve te Shoqerise perkatesisht:  
A. Ortaku Mario VALENTE, ka kontribuar me shumen 20.000Leke, (njezetmije) e barabarte me 20% te shumes totale te kapitalit themeltar.  
B. Ortaku Carlo BISCEGLIA, ka kontribuar me shumen 20.000Leke, (njezetmije) e barabarte me 20% te shumes totale te kapitalit themeltar.  
C. Ortaku Alban NEXHIPI, ka kontribuar me shumen 20.000Leke, (njezetmije) e barabarte me 20% te shumes totale te kapitalit themeltar.  
D. Ortaku Enver BERISHA, ka kontribuar me shumen 20.000Leke, (njezetmije) e barabarte me 20% te shumes totale te kapitalit themeltar.  
E. Ortaku Lefter ROKO, ka kontribuar me shumen 20.000Leke, (njezetmije) e barabarte me 20% te shumes totale te kapitalit themeltar.
- 8.3 E gjithe shuma e kontribuar per kapitalin themeltar eshte nenshkruar plotesisht duke u depozituar ne Banke.

NENI 9  
PJESET E KAPITALIT THEMELTAR



- 9.1 Kapitali themeltar me vlerë prej 100.000 Leke (njeqindmije) ndahet ne 100 pjese, secila me vlerë prej 1.000 leke.
- 9.2 Bazuar ne vlerat qe kontribuojne Ortaket, pjeset e kapitalit themeltar te shoqerise "ALFA & OMEGA" S.H.P.K., zoterohen ne nivelet si vijojne:
- A. Ortaku Mario VALENTE, zoteron 20 pjese, me vlerë 20.000 Leke, (njezettmije) qe perbejne 20% te gjithe vleres se kapitalit themeltar, te cilat renditen nga nga numri 1- 20.
  - B. Ortaku Carlo BISCEGLIA, zoteron 20 pjese, me vlerë 20.000 Leke, (njezettmije) qe perbejne 20% te gjithe vleres se kapitalit themeltar, te cilat renditen nga nga numri 21- 40.
  - C. Ortaku Alban NEXHIPI, zoteron 20 pjese, me vlerë 20.000 Leke, (njezettmije) qe perbejne 20% te gjithe vleres se kapitalit themeltar, te cilat renditen nga nga numri 41- 60.
  - D. Ortaku Enver BERISHA, zoteron 20 pjese, me vlerë 20.000 Leke, (njezettmije) qe perbejne 20% te gjithe vleres se kapitalit themeltar, te cilat renditen nga nga numri 61- 80.
  - E. Ortaku Lefter ROKO, zoteron 20 pjese, me vlerë 20.000 Leke, (njezettmije) qe perbejne 20% te gjithe vleres se kapitalit themeltar, te cilat renditen nga nga numri 81- 100.

#### NENI 10 ADMINISTRIMI


- 10.1 Shoqeria administrohet nga nje administrator i vetem i cili ushtron i vetem te gjitha kompetencat e administrimit me perjashtim te atyre qe sipas Ligjit dhe Statutit i perkasin Ortakut te Vetem. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe pa afat.
- 10.2 Administratori i Shoqërisë per here te pare emerohet Alban NEXHIPI i cili eshte njekohesisht edhe Ortak i Shoqerise. Ai ushtron kete detyre per nje peridhe pa afat.

#### NENI 11 DISPOZITA TE FUNDIT


- 11.1 Shoqëria do te regullohet, përvèç këtij Akti Themelues edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj, i cili do te nënshkruhet nga te gjithe Ortaket e Shoqerise.
- 11.2 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (kater) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

#### THEMELUESIT

Mario VALENTE




Alban NEXHIPI



Tirane me 09.10.2003


Carlo BISCEGLIA



Enver BERISHA



Lefter ROKO



## STATUTI

### I SHOQERISE "ALFA & OMEGA"SH.P.K.



Hyrje:

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ALFA & OMEGA"SH.P.K, eshte themeluar nga:

1. Mario VALENTE, i biri i Timoteos, shtetas Italian, i datelindjes 13.08.1929, me banim ne Torino, ne adresen: Corso Peschiera, 355/9, Cap.10141, Itali, mbajtes pasaportes nr.769449A.
2. Carlo BISCEGLIA, i biri i Micheles, shtetas Italian, i datelindjes 23.06.1938, banues ne Rome ne adresen: Via Tazio Nuvolari, nr.243/E 00142 Itali.
3. Alban NEXHIPI, i biri i Hysenit, shtetas shqiptar, i datelindjes 16.07.1971, banues ne adresen: Gjon Buzuku, nr.70 Tirane, mbajtes i leternjoftimit NF488431.
4. Enver BERISHA, i biri i Kamberit, shtetas shqiptar, i datelindjes 23.12.1968, banues ne adresen: Rr.Gjik Kuqali, nr.37, Tirane, mbajtes i pasaportes nr.1443315.
5. Lefter ROKO, i biri i Xhevairit, shtetas shqiptar, i datelindjes 01.05.1978, banues ne adresen: Rruga e Elbasanit, Pall. prane konviktit te Gjuheve te Huaja. Nr.1/5.

Personat e mesiperm ne cilesine e Ortakeve Themelues te Shoqerise "ALFA & OMEGA"SH.P.K, dhe ne perputhje me ligjin, hartoje dhe Statutin e Shoqerise kesaj Shoqerie i cili perbehet nga nenet si me poshte vijon:

#### NENI 1 EMERTIMI I SHOQERISE

- 1.1 Emërtimi i Shoqerise është "ALFA & OMEGA"SH.P.K, shkurt "A&O".

#### NENI 2 FORMA

- 2.1 Forma e Shoqerise "ALFA & OMEGA"SH.P.K, eshte "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" Sh.p.k. e cila sipas ligjit per Shoqerite Tregetare, perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

#### NENI 3 SELIA

- 3.1 Selia e Shoqerise ndodhet në Tirane, ne adresen: Lagje "Vaso Pasha", Pall. 13/I Tirane.

#### NENI 4 KOHEZGJATJA

- 4.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte per një periudhe pa afat.

#### NENI 5 TERRITORI

*Dalibor Mavrovincija, Ardo Nestor, Engjëll Lekaj, 1*

- 6.1 Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashtë saj, gjithashtu ajo mund te krijoje dege, filiale, ose perfaqesi, ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise apo ne shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkatase.

  
**NENI 7**  
**OBJEKTI I AKTIVITETIT TE SHOQERISE**

Objekt i Aktivitetit te Shoqerise eshte:

- 7.1 Kryerja e veprimtarise radiotelevizive ne menyre eskluzive dhe nepermjet transmetimit ne Radio Lokale (vendore).

**NENI 8**  
**KAPITALI THEMELTAR**

- 8.1 Kapitali Themeltar i Shoqerise ka vleren 100.000Leke(njeqindmije) i cili ndahet ne 100 pjese, secila me vlore prej 1.000 leke.
- 8.2 Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet, me vendimin e marre prej 3/4, nga Asambleja e Ortakeve. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparrësishë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre, por ata janë të lirë të heqin dorë nga kjo e drejtë.
- 8.3 Kapitali themeltar i shoqerise mund te zgjedhohet, me vendimin e marre prej 3/4, e Asamblese se Ortakeve. Zgjedhimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë mbi pjeset e kapitalit qe perfaqesojne.

**NENI 9**  
**KONTRIBUTET**

- 9.1 Kapitali i themeltar i shoqerise "ALFA & OMEGA"SH.P.K, perbehet nga kontributet e Ortakeve si vijojne:
- A. Ortaku Mario VALENTE, ka kontribuar me shumen 20.000Leke, (njezetmije) e barabarte me 20% te shumes totale te kapitalit themeltar.
- B. Ortaku Carlo BISCEGLIA, ka kontribuar me shumen 20.000Leke, (njezetmije) e barabarte me 20% te shumes totale te kapitalit themeltar.
- C. Ortaku Alban NEXHIPI, ka kontribuar me shumen 20.000Leke, (njezetmije) e barabarte me 20% te shumes totale te kapitalit themeltar.
- D. Ortaku Enver BERISHA, ka kontribuar me shumen 20.000Leke, (njezetmije) e barabarte me 20% te shumes totale te kapitalit themeltar.
- E. Ortaku Lefter ROKO, ka kontribuar me shumen 20.000Leke, (njezetmije) e barabarte me 20% te shumes totale te kapitalit themeltar.

**NENI 10**  
**PJESET E KAPITALIT THEMELTAR**

Bazuar ne vlerat qe kontribuojne Ortaket, pjeset e kapitalit themeltar te shoqerise "ALFA & OMEGA"SH.P.K, zoterohen ne nivelet si vijojne:



- A. Ortaku Mario VALENTE, zoteron 20 pjese, me vlore 20.000Leke, (njezetmije) qe perbejne 20% te gjithe vleres se kapitalit themeltar, te cilat renditen nga nga numri 1- 20.
- B. ~~NOTER TIRAS~~ Ortaku Carlo BISCEGLIA, zoteron 20 pjese, me vlore 20.000Leke, (njezetmije) qe perbejne 20% te gjithe vleres se kapitalit themeltar, te cilat renditen nga nga numri 21- 40.
- C. Ortaku Alban NEXHIPI, zoteron 20 pjese, me vlore 20.000Leke, (njezetmije) qe perbejne 20% te gjithe vleres se kapitalit themeltar, te cilat renditen nga nga numri 41- 60.
- D. Ortaku Enver BERISHA, zoteron 20 pjese, me vlore 20.000Leke, (njezetmije) qe perbejne 20% te gjithe vleres se kapitalit themeltar, te cilat renditen nga nga numri 61- 80.
- E. Ortaku Lefter ROKO, zoteron 20 pjese, me vlore 20.000Leke, (njezetmije) qe perbejne 20% te gjithe vleres se kapitalit themeltar, te cilat renditen nga nga numri 81- 100.

#### NENI 11 TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

- 11.1 Pjesët e kapitalit themtar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, sipas legjisacionit ne fuqi.
- 11.2 Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te tretë qe nuk bejne pjese ne shoqeri, me vendimin e marre me shumicen e Ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4, e pjeseve te kapitalit themeltar.
- 11.3 Ne rastet kur njeri apo disa nga Ortaket deshirojne te transfeojne pjeserisht apo plotesisht, pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar, tek te tretet, me pare duhet qe oferta per shitje t'u behet ortakeve te tjere te shoqerise, me te njejtat kushte qe do t'i behet te treteve.
- 11.4 Bashkeshori, paraardhesi ose pasadhesi behen ortak, vetem pasi te jene miratuar nga Ortaket sipas kushteve qe ata caktojne.

#### NENI 12 ORTAKET DHE ASAMBLEJA

- 12.1 Ortakët përballojnë humbjet e Shoqerise vetem deri në kufirin e vlerës qe kane kontribuar në kapitalin e saj themeltar.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zoteron. Nje Ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e Asamblese nga nje Ortak tjetër i shoqerise, me kusht qe autorizimi te jete dhene me procure te posaçme.
- 12.3 Mbledhja e Asamblesë mund të kërkohet nga një ose disa ortakë që zoterojnë mbi 1/10 e pjesëve të kapitalit themeltar. Lajmerimi behet nga administratori ose nga ekspertët kontabel të autorizuar, po qe se ka të tillë.
- 12.4 Sipas rëndësisë se çeshtjeve qe trajtohen dhe vendimeve qe merren, mbledhja e Asamblesë eshte e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
- 12.5 Asambleja e zakonshme vendos për çeshtje të tillë si:
- A. Miratimi i Politikes se Personelit, ku perfishen miratimi i struktura, emerimi/shkarkimi i personelit, pagat.
  - B. Miratimin e Rregullores se funksionimit te brendeshem.

- C. Miratimin e politikave/projekteve per shtrirjen, zmadhimin/zvogelimin e aktivitetit dhe te investimeve.
- D. Emërimi / shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujdatoreve.
- E. Miratimi i Raporteve të administritimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive yjetore dhe ndarjen e fitimit etj.

12.6 Ne mbledhjen e Asamblese se zakonshme vendimet merren nga një ose disa Ortake që përfaqësojnë më shume se gjysmen e pjesave të kapitalit themeltar.

12.7 Asambleja e jashtëzakonshme vendos për çështje të tillë si:

- A. ndryshimin e statutit,
- B. zvogelimin/zmadhim i kapitalit themeltar,
- C. transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët,
- D. zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likujdimi i saj,
- E. shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera etj, si dhe çdo çështje tjeter që parashikohet ne ligj.

12.8 Asambleja e jashtëzakonshme vendos me unanimitetin e te gjithe ortakëve që përfaqësojnë kapitalin e Shoqerise "ALFA & OMEGA"SH.P.K.

#### NENI 13 ADMINISTRIMI


- 13.1 Shoqëria administrohet nga një administrator i cili eshte person fizik i zgjedhur brenda ose jashtë bashkesise se ortakeve.
- 13.2 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim te ortakëve që përfaqësojnë me teper se gjysmen e pjesave të kapitalit themeltar.
- 13.3 Emërimi i administratorit behet për një periudhe pa afat. Asambleja e Ortakeve mund te vendose shkarkimin e Administratorit ne çdo kohe.

#### NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

- 14.1 Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrëthanat me perjashtim te:
- kompetencave qe ligji apo ky Statut ua jep shprehimisht Ortakeve;
  - kryen shitjen e pasurive te paluajtshme vetem pasi ka marrë miratimin nga Asambleja e Ortakeve.
- 14.2 Per çeshtjet qe jane kompetence e Asamblese se Ortakeve, Administratori harton projekte të cilat ja paraqet per miratim Asamblese dhe pasi eshte dhene miratimi nga Asambleja ben ekzekutimin e tyre.

#### NENI 15 EMERIMI I PER HERE TE PARE I ADMINISTRATORIT

- 15.1 Administrator i Shoqerise "ALFA & OMEGA"SH.P.K, per here te pare emerohet Alban NEXHIFI, i cili eshte njekohesish edhe Ortak i Shoqerise. Ai ushtron kete detyre per nje peridhe pa afat.



Alban NEXHIFI

NENI 16  
EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

- 16.1 *Në rast nevoje si dhe kur kerkohet nga ligji, kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për 2 vite financiare me mundësi rizgjedhje nga ortakët që përfaqësojnë mbi 1/2 e kapitalit themeltar.*
- 16.2 Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

NENI 17  
VITI FINANCIAR

- 17.1 Çdo vit finanziar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

NENI 18  
LLOGARITE VJETORE

- 18.1 Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht, nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asambleja, me vendimin e ortakeve që zoterojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar.
- 18.2 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finanziar.

NENI 19  
DIVIDENTET


- 19.1 Asambleja, me vendimin e ortakeve që zoterojne jo me pak se 1/2, e pjesëve të kapitalit themeltar, vendos per shperndarjen ose invistimin e dividenteve. Fitimi (dividentet) ndahen proporcionalisht me perqindjen e pjesemarries se secilit ortak ne pjeset e kapitalit themeltar.

NENI 20  
PRISHJA

- 20.1 Shoqëria prishet me përfundimin e afatit kur ky eshte caktuar, kur kjo vendoset nga Ortaket, si dhe kur jane arsyet e parashikuara me ligj.
- 20.2 Shoqëria nuk prishet kur njëri prej ortakeve falimenton, bëhet i paafët ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortaket e tjere qe kane mbetur ndersa per futjen e trashegimitareve apo te bashkeshorit te ndare veprohet duke zbatuar nenin (11.4) te ketij statuti.

NENI 21  
LIKUJDIMI

- 21.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja emëron një likujdues, i cili i paraqet asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.
- 21.2 Në fund të procesit të likujdimit Asambleja vendos, me vendimin e ortakeve që zoterojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar, mbi bilancin përfundimtar finanziar, mbi aktin e rregullshëmrisë së punës së likujduesit dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.



- 21.3 Mbës pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së pjesëve të kapitalit themeltar tek kontribuesit përkatës, likujdiesi ndan kapitalet e mbeturë ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin themeltar.

NENI 22  
SHNDERRIMI I SHOQERISE

- 21.1 Shnderrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri kolektive ose në shoqëri komandite mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve, ndërsa shnderrimi në shoqëri anonime, me miratimin e ortakëve që zotërojnë të paktën 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

NENI 22  
MOSMARREVESHIJET

- 22.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit ndërmjet ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Tirane.


NENI 23


- 23.1 Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete statut, do te zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi per Shoqerite Tregtare.
- 23.2 Ky Statut mund te ndryshohet plotesisht ose te ndryshohet pjeserisht nga Asambjeja e Ortakeve te Shoqerise.
- 23.3 Ky Statut, hartohet ne ne gjuhen shqipe, ne 4 kopje me vlerë te njëjtë dhe nenshkruhet nga Ortaket Themelues.


THEMELUESIT

Mario VALENTE  


Alban NEXHIPI

Alban Nexhipi  


Carlo BISCEGLIA  


Enver BERISHA  


Lefter ROKO  
